



Kompania Rajonale e Ujësjetësit
"Hidromorava" SH.A
Regionalna Kompanija za Vodovod
"Hidromorava" D.D
Regional Company for Water
"Hidromorava" J.S.C
Gjilan

Hidromorava Gjilan KOMPANIA RAJONALE
E UJËSJELLËSIT
HIDROMORAVA Sh.a.
No. 177 Data 27.02.2026
GJILAN

REPUBLICA KOSOVA	
MINISTRIE E EKONOMISE	
MINISTRIA E EKONOMISE	
MINISTRI	
Njësia Orig.	01/3
Org. Jodite	
Org. Unit	
No. i Takimit	310
Org. Struktura	
No. i pagimit	02.03.26
PRISHTINE	
NO. 1	

**RREGULLORE PËR PAGAT, KOMPENSIMET
TJERA DHE STIMULIMET NË KRU
"HIDROMORAVA" - SH.A.**



Kompania Rajonale e Ujësjiellësit
"Hidromorava" SH.A
Regionalna Kompanija za Vodovod
"Hidromorava" D.D
Regional Company for Water
"Hidromorava" J.S.C
Gjilan

Bazuar në nenin 34, paragrafin 1 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, nenin 20 të Ligjit mbi plotësim ndryshimin e Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike nr.04/L-111, Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, si dhe Udhëzuesit për metodologjinë e përcaktimit të koeficientëve të pagave për personelin e KRU-ve, Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjiellësit "Hidromorava" - Sh.A., në Gjilan, miraton këtë:

RREGULLORE PËR PAGAT, KOMPENSIMET TJERA DHE STIMULIMET NË KRU "HIDROMORAVA" - SH.A.

Neni 1 **Qëllimi**

1. Kjo Rregullore përcakton rregullat për përcaktimin e pagave dhe kompensimeve të tjera të punonjësve të ndërmarrjes publike KRU "Hidromorava" - Sh.A.

Neni 2 **Fushëveprimi**

1. Me këtë Rregullore rregullohen pagat mujore, kompensimet tjera dhe stimulimet të cilat i paguhen punonjësve të KRU "Hidromorava" - Sh.A., konform obligimeve dhe përgjegjësive të tyre për kryerjen e detyrave të punës dhe të drejtave për realizimin e të ardhurave nga puna e tyre.
2. Ky akt vlen dhe do zbatohet për të gjithë të punësuarit në KRU "Hidromorava" - Sh.A.

Neni 3 **Përkufizime**

1. Në këtë Rregullore, shprehjet/fjalët kanë këtë kuptim:
 - 1.1. "Paga bazë" është komponenti kryesor apo i vetëm i pagës që i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë. Kompleksiteti është rezultat i kombinuar i përgjegjësisë, rëndësisë dhe lirisë të vendimmarrjes, vështirësisë dhe rrezikshmërisë në kryerjen e detyrave në atë funksion, pozitë apo gradë, si dhe kufizimeve që shoqërojnë punën.



Kompania Rajonale e Ujësjetësit
"Hidromorava" SH.A
Regionalna Kompanija za Vodovod
"Hidromorava" D.D
Regional Company for Water
"Hidromorava" J.S.C
Gjilan

- 1.2. "Pagesa shtesë" janë pagesat të cilat i shtohen të ardhurave bazë të përcaktuara me Ligjin e Punës në fuqi në Kosovë.
- 1.3. "Grupi i pagës" përbëhet nga grup funksionesh, pozitash apo gradash me nivel të njëjtë apo pothuajse të njëjtë të kompleksitetit, që përfitojnë të njëjtën pagë bazë.

Neni 4

Parimet e sistemit të pagave

1. Pagat bazohen në parimet e përcaktuara, si vijon:
 - 1.1. I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e punës në pajtim me Ligjin e Punës së Kosovës, si dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit.
 - 1.2. Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me kontratën e punës.
 - 1.3. Punëdhënësi duhet të lëshoj një dokument për çdo pagesë dhe çdo shtesë tjetër të paguar të punësuarve. Dokumenti duhet të përmbaj të dhënat e nevojshme dhe i ofrohet të punësuarit fizikisht apo përmes postës elektronike.
 - 1.4. Pagat paguhet vetëm me transferim bankar, me ç'rast punëdhënësi duhet të mbajë regjistrin për pagesat e kryera.

Neni 5

Paga e të punësuarve

1. Paga mujore e të punësuarve në KRU "Hidromorava" - Sh.A., është pagesa që përfiton i punësuari për punën e kryer për një pozitë të caktuar sipas kontratës së punës.
2. Paga mujore paguhet në afatet e përcaktuara me aktin e brendshëm të punëdhënësit, ose kontratën e punës, së paku një herë në muaj, më së largu deri më datë 5 të secilit muaj.
3. Pagesat shtesë, që nuk rregullohen me Ligjin nr.03/L-212 të Punës janë:
 - 3.1. Shtesa për ushqim;
 - 3.2. Kompensimi për përvojën e punës;
 - 3.3. Paga e 13-të për të punësuarit e KRU "Hidromorava" - Sh.A.



Kompania Rajonale e Ujësjetësit
"Hidromorava" SH.A
Regionalna Kompanija za Vodovod
"Hidromorava" D.D
Regional Company for Water
"Hidromorava" J.S.C
Gjilan

Neni 6

Paga bazë e punonjësit

1. Paga bazë është pjesa fikse e pagës që përfitohet për punën e kryer me orar të plotë apo punën me orar të pjesshëm, në një funksion apo pozitë të caktuar që përcaktohet nga grupi dhe klasa e pagës së cilës i përket funksioni apo pozita, ashtu siç është përcaktuar në shtojcën e kësaj Rregullore.
2. Paga bazë e të punësuarve përcaktohet nga Grupi i Pagës të cilës i përket sipas Shtojcës së bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.
3. Vlera e koeficientit është 240€ (dyqind e katërdhjetë euro) për të gjithë të punësuarit në Kompani.

Neni 7

Kompensimi për punë jashtë orarit të rregullt të punës

1. Paga shtesë e përfituar për kohën më të gjatë se orari i rregullt i punës, punëmarrësi i realizon njëjtë siç janë parashikuar me Ligjin nr.03/L-212 të Punës.
2. Punëmarrësit i takon paga shtesë si përqindje e mbivendosur në pagën bazë në këto norma dhe kategorizime:
 - 2.1) 20 % në orë për kujdestari;
 - 2.2) 30 % në orë për punë gjatë natës;
 - 2.3) 30 % në orë për punë jashtë orarit;
 - 2.4) 50 % në orë për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave.
3. Puna jashtë orarit të rregullt të punës për një punëtor brenda javës nuk mund të kalojë më shumë se 8 orë.
4. I punësuarit mund të kërkojë nga punëdhënësi që në vend të pagës shtesë nga paragrafi i lartcekur, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi.
5. Punëdhësi mund të vendosë që një pjesë të punës jashtë orarit të kompensohet me ditë pushimi, në përputhje me përqindjet e parapara në paragrafin 2 të këtij neni.
6. Pagesat e paparashikuara në këtë Rregullore i nënshtrohen zgjidhjeve që janë përcaktuar me Ligjin nr.03/L-212 të Punës.



Kompania Rajonale e Ujësjetësit
"Hidromorava" SH.A
Regionalna Kompanija za Vodovod
"Hidromorava" D.D
Regional Company for Water
"Hidromorava" J.S.C
Gjilan

Neni 8

Ndarja dhe ndryshimi i orarit të punës

1. KRU "Hidromorava" - Sh.A., e organizon punën me orar të rregullt për punëtorët e administratës dhe personelit menaxhues nga e hëna në të premtën nga ora 08:00 deri në ora 16:00.
2. Bazuar në paragrafin 2 të nenit 24 të Ligjit të Punës nr.03/L-212, KRU "Hidromorava" - Sh.A. kur natyra e punës e kërkon një gjë të tillë, e organizon punën me ndërrime, të cilat mund të mbahen edhe gjatë natës, ditëve të festave dhe fundjavave.

Neni 9

Kompensimi për mosshfrytëzimin e pushimit vjetor

1. Nëse për interesa të punëdhënësit, ndonjërit nga punëmarrësit i pamundësohet shfrytëzimi i pushimit vjetor të vitit paraprak deri me datë 30 qershor sipas Ligjit 03/L-212 të Punës, atëherë punëmarrësit i takon shfrytëzimi i ditëve të mbetura vetëm me leje të veçantë që duhet të sigurohet paraprakisht, e të njëjtat mund të shfrytëzohen deri në përfundim të atij viti kalendarik, apo të kompensohen me të holla.

Neni 10

Kompensimi për pagesë të ushqimit

1. Pagesa për ushqim paguhet për çdo ditë të punës e kaluar 8 orë në punë. Vlera e pagesës për ushqim për 1 ditë përcaktohet me vendim të veçantë.
2. Për ditët e mungesës nga puna, siç janë: pushimi vjetor, pushimi mjekësor, pushimet tjera me pagesë dhe mungesat tjera, punëmarrësit nuk i takon pagesa për ushqim.

Neni 11

Mungesa nga puna me pagesë

1. I punësuar ka të drejtë të mungojë nga puna me kompensim të pagës:
 - 1.1. pesë (5) ditë në rast të martesës së tij;
 - 1.2. pesë (5) ditë në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes;
 - 1.3. tri (3) ditë për lindje të fëmijut;
 - 1.4. një (1) ditë për për çdo rast të dhënies vullnetare të gjakut;
 - 1.5. një (1) ditë me rastin e ndërrimit të vendbanimit;
 - 1.6. dy (2) ditë me rastin e vërshimeve, zjarrit apo ndonjë fatkeqësie tjetër elementare në vendbanimin e tij;
 - 1.7. dy (2) ditë për martesën e fëmijut.

Neni 12

Shtesa për përvojën në punë

1. Çdo punëmarrësi i takon shtesa për përvojën e punës në lartësinë 0.5% për çdo vit të plotë të punës së kaluar, përfshirë edhe të punëdhënësit paraprak. Fillimi i ndërrimit të viteve të shërbimit fillon në fillim të vitit fiskal, pra në muajin janar dhe në muajin korrik për të gjithë punëmarrësit.

Neni 13

Paga e trembëdhjetë (13-të) për punësuarit e KRU "Hidromorava" - Sh.A.

1. Bordi i Drejtorëve, pas shqyrtimit të performancës financiare dhe gjendjes së likuiditetit të institucionit, si dhe duke u mbështetur në vlerësimin e performancës vjetore, vendos të miratojë ndarjen e pagës së trembëdhjetë (13-të) për punëtorët.

Neni 14

Stimulimi në rast të festave

1. Në qoftë se Ndërmarrja është në gjendje të qëndrueshme financiare, kërkesat e punëtorëve përmes përfaqësuesve të tyre për stimulim me rastin e festave të rëndësishme (Viti i Ri, festat fetare, 8 Marsi, etj.), mund të shqyrtohen për aprovim.
2. Menaxhmenti duhet të shqyrtoj kërkesat me kujdes, përkitazi me arsyeshmërinë, gjendjen financiare të Ndërmarrjes dhe shumën e arsyeshme monetare.
3. Zyrtari Kryesor Financiar duhet të analizoj dhe të përgjigjet në faktin se a paraqet kërkesa e tillë kundërshtim me planifikimin buxhetor dhe a e ngarkon një stimulim i tillë stabilitetin financiar të Ndërmarrjes.
4. Në qoftë se Menaxhmenti i KRU "Hidromorava" - Sh.A., e presin pozitivisht kërkesën, e njejta përcillet me rekomandim përkitazi me arsyeshmërinë dhe shumën tek Bordi i Drejtorëve për aprovim.

Neni 15

Kompensimi për trajnimet e të punësuarve

1. Punëdhënësi ka të drejtë të dërgoj punonjësit e Kompanisë në trajnime që kanë të bëjnë me punë specifike në interes dhe dobi të Kompanisë.
2. Nëse trajnimi është i organizuar gjatë orarit të punës, koha e trajnimit numërohet si pjesë e orarit të punës dhe i punësuarit ka të drejta të njejta sikurse gjatë punës.

1. Në shenjë respekti për kontributin e dhënë, punëtorit që pensionohet, Ndërmarrja ia jep një dhuratë simbolike në vlerë deri në 100 € (njëqind euro), por jo në vlerë monetare. Kjo dhuratë i jepet secilit punëtor që del në pension i cili ka punuar më shumë se dy vjet në Ndërmarrje.

Neni 18

Ndihma solidare me rastin e vdekjes së të punësuarit

1. Në rast të vdekjes së punëtorit të KRU "Hidromorava" - Sh.A., familja e tij gëzon të drejtën e ndihmës solidare, varësisht prej kohëzgjatjes sa ka punuar në Ndërmarrje, sipas kësaj shkalle:
 - 1.1. Nga një (1) deri në dhjetë (10) vjet të shërbimit, një (1) pagë mujore;
 - 1.2. Nga njëmbëdhjetë (11) deri në njëzet (20) vjet të shërbimit, dy (2) paga mujore;
 - 1.3. Nga njëzetënjë (21) vjet të shërbimit e më shumë, tri (3) paga mujore.

Neni 19

Ndihma solidare me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes së të punësuarit

1. Në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (prindi, bashkëshorti/ja dhe fëmijët), të punësuarit i jepet ndihma solidare në vlerë 200 € (dyqind euro).
2. Të drejtën për ndihmë solidare nga paragrafi 1 i këtij neni e gëzojnë vetëm të punësuarit që jetojnë në bashkësi familjare me të ndjerin/en.

Neni 20

Kompensimi i punëtorëve me gjendje të rëndë shëndetësore dhe të pashërueshme

1. Deri në zgjidhjen e çështjes sociale, për punëtorët me gjendje shëndetësore të rëndë dhe të pashërueshme, të konstatuar nga mjeku specialist i sëmundjes përkatëse, e të cilët nuk mund të ushtrojnë detyrën e tyre, i bëhet kompensimi i të ardhurave në kohëzgjatje deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune, në lartësi prej 50% të pagës.

Neni 21

Interpretimi i Rregullores

1. Për çfarëdo paqartësie eventuale dhe shfaqjes së nevojës për shpjegim më të detajuar, përgjegjësinë për interpretimin e kësaj Rregulloreje e mbanë shërbimi juridik i KRU "Hidromorava" - Sh.A.



Kompania Rajonale e Ujësjetës
"Hidromorava" SH.A
Regionalna Kompanija za Vodovod
"Hidromorava" D.D
Regional Company for Water
"Hidromorava" J.S.C
Gjilan

të ushtrojnë detyrën e tyre, i bëhet kompensimi i të ardhurave në kohëzgjatje deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune, në lartësi prej 50% të pagës.


Neni 21 **Interpretimi i Rregullores**

1. Për çfarëdo paqartësie eventuale dhe shfaqjes së nevojës për shpjegim më të detajuar, përgjegjësinë për interpretimin e kësaj Rregulloreje e mbanë shërbimi juridik i KRU "Hidromorava" - Sh.A.

Neni 22 **Hyrja në fuqi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Bordi i Drejtorëve


U.D. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve
z.Habil Zeqiri

